



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada – Government

*Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - Ministarstvo Inostranih Poslova i Dijaspore -
Ministry of Foreign Affairs and Diaspora*

Datë: 24.05.2024

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), bazuar në Planin Vjetor të Mbështetjes Financiare Publike për Organizatat Joqeveritare 2024 si dhe në bazë të Rregullores MF – nr.-04/2017¹ bën këtë:

**THIRRJE PËR PROJEKTPROPOZIME PËR MBËSHTETJEN DHE FINANCIMIN E SUBJEKTEVE PËR
VEPRIMTARI DHE ANGAZHIM NE KUADËR TË DIPLOMACISË PUBLIKE**

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), përmes Departamentit për Diplomaci Publike (DDP) angazhohet në krijimin dhe promovimin unik të Republikës së Kosovës, duke u munduar të luaj një rol thelbësor në formësimin dhe promovimin e imazhit të vendit në skenën globale. Qëllimi kryesor i DDP-së është të ndërtojë një imazh pozitiv dhe të fuqishëm për Republikën e Kosovës në sytë e komunitetit ndërkombëtar. Kjo do të arrihet përmes promovimit të historive të suksesit, rasteve pozitive dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në një mënyrë inovative dhe të qëndrueshme.

MPJD u bën thirrje të gjitha OJQ-ve në Republikën e Kosovës, fokusi i të cilave është arti dhe kultura, që të aplikojnë për mbështetje financiare për promovimin e fushë veprimtarisë së tyre në arenën ndërkombëtare, duke u bazuar në politikat programore të MPJD-së².

OJQ-të, në përputhje me këtë thirrje publike, mund të aplikojnë me projekt-propozime lidhur me aktivitetet e tyre sipas objektivave të përcaktuara në planin vjetor të mbështetjes financiare publike për organizatat joqeveritare 2024.

OJQ-të mund të aplikojnë me një projekt-propozim që kontribuon në realizimin e aktiviteteve të mëposhtme:

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=14831>

²Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf (rks-gov.net)



- Projekte për aktivitete promovuese në fushën e kulturës, artit dhe sportit (festivale, garat sportive, shfaqje skenike, ekspozita etj.) në shtete të cilat nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës;
- Projekte për aktivitete promovuese në fushën e kulturës, artit dhe sportit (festivale, garat sportive, shfaqje skenike, ekspozita etj.) në shtete njohëse me rëndësi strategjike për promovim;
- Projekte me paraqitje të veçanta dhe karakter promovues të Kosovës në aktivitete të rëndësishme kulturore dhe sportive botërore.;
- Përfshirja e akterëve të jashtëm në aktivitetet brenda Kosovës me qëllim të promovimit të imazhit të vendit;
- Projektet e OJQ-ve vendore në partneritet me OJQ-të e shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën, me qëllim të bashkë organizimit të aktiviteteve promovuese.

Vlera e përgjithshme e planifikuar e thirrjeve për subvencione është € 280,000.

Financimi do të ndahet në tre (3) kategori:

Kategoria I: Aktivitetet që realizohen jashtë Republikës së Kosovës. Buxheti i përgjithshëm € 150,000;

- shuma minimale e mbështetjes financiare për projekt është € 5,000;
- shuma maksimale e mbështetjes financiare për projekt është € 15,000;

Kategoria II: Aktivitetet që realizohen brenda Republikës së Kosovës. Buxheti i përgjithshëm € 90,000;

- shuma minimale e mbështetjes financiare për projekt është € 3,000;
- shuma maksimale e mbështetjes financiare për projekt është € 9,000;

Kategoria III: Aktivitetet që realizohen brenda dhe jashtë të Republikës së Kosovës të organizatave të reja. Buxheti i përgjithshëm € 40,000;

- shuma minimale e mbështetjes financiare për projekt është € 2,000;
- shuma maksimale e mbështetjes financiare për projekt është € 5,000.

Kriteret minimale të aplikimit:



Kategoria I – të jetë OJQ i themeluar së paku 3 (tri) vjet më parë; të ketë menaxhuar projekte së paku në vlerë 20,000 Euro për dy vitet e fundit. Përparësi do të kenë organizatat që kanë përvojë në zbatimin e projekteve/aktiviteteve jashtë vendit. Organizatat aplikuese inkurajohen të bashkëpunojnë me organizata të tjera për organizimin, bashkërendimin dhe realizimin e aktiviteteve, si dhe të bashkë financojnë projekte për ta rritur ndikimin e projektit. Po ashtu, të mos ketë shkelje ligjore ose obligime financiare të pakryera.

Kategoria II – të jetë OJQ i themeluar së paku 1 (një) vit më parë; të ketë menaxhuar projekte së paku në vlerë 10,000 Euro për dy vitet e fundit. Përparësi do të kenë organizatat që kanë përvojë në zbatimin e projekteve/aktiviteteve me karakter promovues. Organizatat aplikuese inkurajohen të bashkëpunojnë me organizata të tjera për organizimin, bashkërendimin dhe realizimin e aktiviteteve, si dhe të bashkë financojnë projekte për ta rritur ndikimin e projektit. Po ashtu, të mos ketë shkelje ligjore ose obligime financiare të pakryera.

Kategoria III – të jetë OJQ i themeluar së paku 3 (tre) muaj më parë me idetë kreative për promovimin e vendit. Përparësi do të kenë organizatat që kanë plan konkret për aktivitetet e ardhshme të tyre. Organizatat aplikuese inkurajohen të bashkëpunojnë me organizata të tjera për organizimin, bashkërendimin dhe realizimin e aktiviteteve, si dhe të bashkë financojnë projekte për ta rritur ndikimin e projektit. Po ashtu, të mos ketë shkelje ligjore ose obligime financiare të pakryera.

Më shumë informacione rreth thirrjes publike:

Të gjitha çështjet që lidhen me ftesën publike mund të sqarohen në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën ddp.mpjd@rks-gov.net, jo më vonë se **29 maj 2024**, në orën **16:00**. Pyetjeve do t'u jepet përgjigje jo më vonë se **05 qershor 2024**, në orën **16:00**.

OJQ-të mund të aplikojnë vetëm me një projekt. Sidoqoftë, inkurajohet bashkë aplikimi i dy (2) ose maksimumi i tri (3) OJQ-ve me një projekt. Në rast të bashkë aplikimit, shuma maksimale për financim mbetet sipas kategorisë përkatëse, pra në kategorinë I shuma maksimale për aplikim mbetet € 15,000, te kategoria II, shuma maksimale për aplikim mbetet € 9000, ndërsa te kategoria III, shuma maksimale për aplikim mbetet € 5,000.

Afati për aplikim: Afati për dorëzimin e propozimeve është nga data **24 maj 2024** deri më **14 Qershor 2024**. Periudha e zbatimit të projektit është nga **korrik 2024** deri më **31 dhjetor 2024**.



Propozim projektet duhet të dorëzohen përmes postës

elektronike: e-mail: projektet.mpjd@rks-gov.net

Mbishkrimi – Projekt propozime për mbështetje financiare 2024

Mbështetja financiare e OJQ-ve duhet të bazohet në këto parime të përgjithshme:

PARIMET E PËRGJITHSHME

- Konkurrenca;
- trajtimi i barabartë dhe mos diskriminimi i aplikuesve, si dhe gjithë përfshirja gjinore e përfituesve;
- transparenca në procedura dhe vendimmarrje në gjithë ciklin e ofrimit të mbështetjes financiare, duke përfshirë publikimin e kriterëve dhe të procedurave, aplikimin, vendimmarrjen dhe përzgjedhjen e përfituesve;
- kriterë të caktuar më parë, të cilat do të mundësojnë vlerësimin e propozimeve të aplikuesve kundrejt objektivave dhe prioritetëve të mbështetjes financiare;
- parimi i efektivitetit dhe i ekonomizimit në shfrytëzimin e fondeve publike, duke siguruar që të arrihen objektivat dhe prioritetet e parapara me një kosto sa më të favorshme për shoqërinë;
- respektimi i plotë i parimeve të llogaridhënies dhe raportimi për shfrytëzimin e fondeve publike;
- financimi përmes fondeve publike të projekteve dhe programeve që janë me prioritet për Republikën e Kosovës dhe në interes të publikut;
- ruajtja e pavarësisë së përfituesve;
- parandalimi i çfarëdo konflikti të interesit;
- sigurimi i dy shkallshmërisë në trajtimin e ankesave të aplikuesve;
- parandalimi i financimit të çfarëdo aktiviteti të subjekteve politike.

SHPENZIMET E PRANUESHME

Përmes fondeve publike të kësaj thirrjeje publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore e specifikuar me këto udhëzime. Në projekt/programin do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme

Shpenzimet, sipas kostove të pranueshme direkte, përfshijnë shpenzimet që janë direkt të lidhura me zbatimin e disa aktiviteteve të projektit ose të programit të propozuar, të tilla si:

- organizimi i aktiviteteve edukuese, tryeza të rrumbullakëta (në mënyrë të veçantë duhet të identifikohet lloji dhe çmimi i secilit shërbim);
- materialet shpenzuese;
- shërbime grafike (prepress, shërbimet për shtypjen e fletushkave, broshurave, revistave, etj., duke specifikuar llojin dhe qëllimin e shërbimit, sasinë, çmimin e njësisë, etj.);
- shpenzimet e pagave dhe të pagesave për menaxherët e projektit/programit, të kontraktuesve të projektit nga organizatat dhe/ose partnerët e jashtëm të përfshirë në projekt (kontratat e të drejtave të autorit dhe të drejtave pronësore, kontratat e tjera, kontratat e punësimit), duke specifikuar emrin e personave të angazhuar, kompetencat e tyre profesionale, numrin e muajve të angazhimit dhe shumën mujore bruto të kompensimit;
- shpenzimet e komunikimit (shpenzimet e telefonit, internetit, etj.), këto shpenzime duhet të jenë të përcaktuara (caktuara);
- shpenzimet e udhëtimit;
- shpenzimet për transportin dhe akomodimin (aty ku është e nevojshme duke specifikuar numrin e njerëzve, destinacionin, shpeshtësinë dhe qëllimin e udhëtimit, si dhe llojin e transportit publik, llojin e akomodimit dhe numrin e netëve);
- kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e aktiviteteve të projektit ose të programit.

Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë p.sh:

- investimet në kapital ose kredi për investime, fonde të garancisë;
- kostot e blerjes së pajisjeve, mobilieve dhe punëve të vogla ndërtimore, në qoftë se kalojnë vlerën prej 10% të totalit të kostove të pranueshme të projektit;
- shpenzimet e interesit për borxhin;
- gjokat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e procedurave gjyqësore;
- pagesa e bonuse për punonjësit;
- detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive, tarifat për transferet financiare dhe tarifat e tjera krejtësisht të një natyre financiare;
- kostot që tashmë janë të financuara nga burime publike apo shpenzime në periudhën e projektit të financuar nga burime të tjera;



- blerja e pajisjeve të përdorura, makineri dhe mobilie etj.;
- kostot që nuk mbulohen nga marrëveshja (kontrata me ofruesin e mbështetjes financiare);
- donacionet bamirëse;
- kredi për organizata të tjera ose individë;
- kostot e tjera që nuk janë të lidhura direkt me përmbajtjen dhe objektivat e projektit;
- financim të çfarëdo aktiviteti të subjekteve politike.

Për të kaluar vlerësimin procedural, organizatat aplikuese duhet t'i përmbushin kriteret e përgjithshme dhe specifike, të specifikuara më poshtë. Organizatat që e kalojnë fazën e vlerësimit procedural, vlerësohen në përmbajtje të projekt propozimeve.

KRITERET E PËRGJITHSHME

1. Organizatat aplikuese duhet t'i plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara si në vijim:

1.1. të jenë të regjistruara si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe jashtë saj. Me rastin e aplikimit, OJQ-ja duhet të dëshmojë këtë kërkesë përmes dërgimit të kopjes së certifikatës së regjistrimit;

1.2. të jenë të pajisura me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës. Me rastin e aplikimit, OJQ-ja duhet të dëshmojë këtë kërkesë përmes kopjes së certifikatës së numrit fiskal;

1.3. t'i kenë të kryera të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit. Ndonëse mund të ketë detyrime të pashlyera në momentin e aplikimit, OJQ-ja që përfiton nga fondet, publike para nënshkrimit të kontratës duhet të dëshmojë se ose i ka kryer obligimet tatimore, ose ka arritur ndonjë marrëveshje me ATK-në për kryerjen e tyre në të ardhmen. Ekzistenca e borxheve dhe obligimeve të tjera të pashlyera nuk guxon të ndikojë në implementimin e projektit, prandaj zgjidhja e çfarëdo detyrimi të tillë para nënshkrimit të kontratës është e domosdoshme. Bashkë me dokumentet e ATK-së, të dorëzohet edhe forma e deklaratës së aktiviteteve të financuara nga fonde publike (Formulari F13);

1.4. të mos ketë pranuar mjete nga burime të tjera të financimit për të njëjtat aktivitete. Prandaj, me rastin e aplikimit kërkohet një deklaratë që e shmang financimin e dyfishtë për aktivitetet e njëjta (Formulari F11); të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi ndërmjet aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore ose institucionit publik, siç parashihet sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës;

1.5. të dorëzojnë projekt propozimin sipas formularit e aplikacionit të projektit (Formulari F9), së bashku me formularin e propozim buxhetit (Formulari F10).



- 1.6. Në raste të partneritetit dhe bashkë aplikimit të organizatave për realizim të aktiviteteve, duhen dorëzuar deklarata e partneritetit (Formulari F12) dhe deklarata e përbashkët (Formulari F14) nga partnerët ose kontraktuesit e tjerë për zbatime të aktiviteteve.
2. Në rast të dështimit për përmbushjen e ndonjërit nga kriteret e përgjithshme, aplikuesi nuk mund të kualifikohet për mbështetje financiare.



KRITERET SPECIFIKE

1. Në mënyrë që aplikacioni të konsiderohet i kompletuar, aplikuesi duhet t'i plotësojë edhe kriteret e veçanta minimale, të parapara me dispozitat sipas Rregullores MF – nr.– 04/2017³, si në vijim:

- 1.1. të dorëzojë brenda afatit të thirrjes projekt propozimin, i cili ndër të tjera përmban të dhënat për qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të dhënat e tjera sipas formularit përkatës, i përcaktuar sipas thirrjes publike;
- 1.2. projekt propozimi të jetë i shoqëruar me një propozim buxhet, sipas formatit të përcaktuar sipas thirrjes publike dhe manualit për zbatimin e kësaj rregulloreje;
- 1.3. të dorëzojë të dhëna për personelin kyç, duke specifikuar detyrat e tyre, duke siguruar CV-të e tyre së bashku me një deklaratë pranimi nga ana e tyre se do të punojnë për projektin/programin, në rast të përfitimit të mbështetjes financiare, nëse kjo është e domosdoshme sipas thirrjes;
- 1.4. t'i sigurojë dëshmitë e duhura për projektet, për të cilat kërkohet bashkëfinancim, nëse është e aplikueshme;
- 1.5. të dëshmojë se ka përvojë në realizimin e projekteve/programeve të ngjashme, duke siguruar dëshmi të realizimit të projekteve të ngjashme në të kaluarën, nëse kjo është e domosdoshme sipas thirrjes përkatëse; dhe
- 1.6. të paraqesë leje/licencë për ushtrimin e veprimtarisë në rastet kur me legjislacionin në fuqi ushtrimi i një veprimtarie të tillë mund të kryhet vetëm me leje/licencë nga autoritetet publike.

2. Kërkesa të tjera specifike, që mund të jenë të nevojshme për një program apo projekt specifik sipas thirrjes publike, mund të përcaktohen nga ofruesit e mbështetjes financiare dhe ato duhet të jenë në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje.

3. Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret specifike, aplikacioni do të konsiderohet i pakompletuar dhe, si i tillë, nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

4. Aplikuesi duhet të dëshmojë se i plotëson kriteret specifike, duke i dorëzuar dokumentet përkatëse sipas dispozitave të këtij neni dhe thirrjes publike.

⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=14831>



Vlerësimi i përmbajtjes së projekt propozimeve do të bëhet duke u bazuar në kriteret e përgjithshme të vlerësimit dhe në kriteret specifike të vlerësimit, të renditura më poshtë.

KRITERET E PËRGJITHSHME TË VLERËSIMIT

Kriteret e përgjithshme të vlerësimit të përmbajtjes së projektit duhet të shërbejnë si udhëzues se si të strukturohet projekt propozimi, në përputhje me nevojat e ofruesit të përkrahjes financiare, si dhe të kuptohet se në cilat baza të përgjithshme do të vlerësohet përmbajtja e propozimeve. Duhet të bazohet në kriteret e mëposhtme:

- A. vlerësimi i përputhshmërisë së objektivave të programit ose projektit me objektivat dhe fushat prioritare të thirrjes, si dhe me objektivat prioritare të fushës, në të cilën është shpallur thirrja, sipas së cilës do të zbatohet projekti;
- B. cilësia dhe rëndësia e aplikimit (natyra profesionale e programit apo projektit dhe ndërlidhja e tij me strategjitë kombëtare, objektivat dhe parimet e përcaktuara në thirrjen publike, duke përcaktuar grupet e synuara dhe përfituesit, fizibilitetin, rezultatet e pritshme, efektet, etj.);
- C. kapaciteti i aplikuesit (burimet e nevojshme njerëzore për implementimin e projektit, ekspertizën, disponueshmëria e njerëzve të përfshirë në projekt ose vlerësimin e përfshirjes kompetencat e personelit të angazhuar, ekspertëve të jashtëm etj. Kapacitetet organizative dhe burimet njerëzore duhet të vlerësohen në përputhje me burimet financiare që do të ndahen për aplikuesit;
- D. vlerësimi i përvojës së aplikuesit në zbatimin e projekteve (aktivitete të mëparshme, pajtueshmëria me programin, referencat etj., të cilat mund të paraqiten si dokumentacion shtesë);
- E. vlerësimi i partnerëve për bashkëpunim në implementimin e projektit/programit;
- F. vlerësimi i buxhetit të programit / projektit (realiteti dhe efektiviteti i buxhetit, ndërlidhja e tij me aktivitetet dhe rezultatet e pritshme, kontributi i vetë aplikuesit ose bashkëfinancimi nga donatorë të tjerë. Komisioni duhet të analizojë buxhetin kundrejt aktiviteteve, për të vlerësuar nëse është real.
- G. vlerësimi i mekanizmave të qeverisjes të menaxhimit të rrezikut në zbatimin e programit apo projektit;
- H. qëndrueshmëria e programit / projektit.
- I. Nëse projekt propozimet e organizatave janë në përputhje me kriteret e përgjithshme, do të kalojnë në vlerësimin e përmbajtjes në bazë të kriterëve specifike, si më poshtë. Organizatat që nuk kalojnë **50 pikë, do të diskualifikohen**. Organizatat e tjera do të rangohen në bazë të pikëve të vlerësuar.



Kriteret specifike të vlerësimit	Pikët
A. Kapaciteti i organizatës ⁴ - a posedon organizata aplikuese aftësitë, përvojën dhe kapacitetet e strukturën menaxhuese për të zbatuar projektin.	
Aftësitë dhe përvoja menaxhuese në zbatimin e projekteve të ngjashme?	10 pikë
Staf të mjaftueshëm për të zbatuar projektin?	10 pikë
Shuma financiare e menaxhuar në të kaluarën?	10 pikë
Totali i pikëve të mundshme	30 pikë
B. Relevanca e projektit/programit - sa relevant është projekt propozimi me fushat prioritare të thirrjes dhe sa janë të arritshme, të qëndrueshme dhe të zbatueshme aktivitetet e propozuara.	
Relevanca e projektit me objektivat dhe prioritetet e thirrjes?	10 pikë
A ka objektiva të qarta dhe të realizueshme?	5 pikë
A ka definim të mirë i ndikimit të projektit në përmbushjen e objektivave të DDP?	5 pikë
A do të fokusohet projekti në promovimin e RKS përmes artit dhe kulturës?	10 pikë
Totali i pikëve të mundshme	30 pikë
C. Buxheti - a janë kostot reale, ekonomike dhe në përputhje me aktivitetet e planifikuara?	
A janë kostot e aktiviteteve të detajuara mirë dhe reale?	10 pikë
A janë harxhimet relevante me nevojat e projektit?	5 pikë
A ka zotim për bashkëfinancim nga organizatat zbatuese?	5 pikë
Totali i pikëve të mundshme	20 pikë
D. Prioritetet	
A është propozimi në partneritet me organizata/institucione të tjera?	5 pikë
A do të ndikojë projekti në rritjen e njohurive të qytetarëve të huaj për RKS?	5 pikë
A do të ndikojë projekti në zhvillimin e raporteve të qëndrueshme me akteret jashtë vendit	5 pikë
A do të ndikojë projekti në imazhin e RKS tek vendet jo njohëse?	5 pikë
Totali i pikëve të mundshme	20 pikë

⁴ Kategoria III pjesërisht lirohet nga vlerësimi i kriterit A.



Numri total i pikëve	100 pikë
-----------------------------	-----------------

Organizatat duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushat e cekura më lart. OJQ-të, po ashtu, duhet t'i kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente, sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës, dhe t'i kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, si dhe të gjithë ofruesve të tjerë të mbështetjes financiare publike.

Procesi i pranimit, i hapjes dhe i shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarit tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Rregulloren për subvencione, MF – nr.-04/2017. Po ashtu, është specifikuar më poshtë në kalendarin e realizimit të thirrjes.

Ngarkimi i dokumentit të gabuar ose jo të skanuar mirë, me pamje jo të qartë, konsiderohet mungesë e dokumentit. Nuk do të pranohet ndryshimi i subjektit të aplikuesit.

Të gjithë aplikuesit, të cilët i kanë ndërruar të dhënat e tyre, duhet të sigurohen që t'i përditësojnë informatat gjatë periudhës së afatit të aplikimit për subvencione.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë në këtë thirrje publike dhe që i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara sipas thirrjes publike.

Inkurajohen OJQ-të të prezantojnë projekte që shfaqin vlerat demokratike, multietnike, diversitet kulturor të Republikës së Kosovës dhe barazi gjinore.

Lista e dokumenteve të nevojshme për aplikim

1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
2. Certifikata e numrit fiskal;
3. Vërtetimi për kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore;
4. Të ketë dorëzuar projekt propozimin të plotësuar në formatin e aplikacionit, sipas kërkesave të thirrjes publike;
5. Të ketë dorëzuar propozimin e buxhetit në formatin sipas kërkesave të thirrjes dhe të plotësuar në tërësi;
6. Deklarata e nënshkruar se për të njëjtin projekt nuk është pranuar financim i dyfishtë nga burimet e tjera;
7. Pasqyrat financiare vjetore dhe deklarata se OJQ-ja i ka përgatitur dhe i ka dorëzuar pasqyrat financiare vjetore për vitet përkatëse sipas kategorisë;
8. Një deklaratë, përmes së cilës tregojnë se i kanë përmbushur detyrimet nga mbështetjet financiare publike të mëhershme;
9. T'i dorëzojë deklaratat e partneritetit në rastet kur propozohet implementimi i projekteve në partneritet;
10. Të dorëzojë deklaratë për projektet e financuara nga burimet publike të financimit në vitin 2023 (nëse ka);
11. T'i dorëzojë CV-të e përfaqësuesve të organizatës që do ta menaxhojnë dhe do ta zbatojnë projektin;
12. Të dërgojë certifikatën e statusit të përfituesit publik, nëse është e aplikueshme për organizatë;
13. Vërtetimi/konfirmimi nga banka përkatëse i llogarisë bankare të OJQ-së, si dhe qarkullimi për vitet përkatëse sipas kategorisë (nuk pranohet kopja e kartelës bankare);
14. Kopja e letërnjoftimit/pasaportës e përfaqësuesit të OJQ-së.

Vërejtje/kujdes: Aplikacionet që nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar, do të diskualifikohen. Dokumentet **nuk pranohen pas mbylljes së thirrjes publike.**

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike, pyetjet, mund të sqarohen në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: ddp.mpjd@rks-gov.net.

- ***nëse është e aplikueshme*** - nënkupton obligimin sipas legjislacionit të vendit ku është e regjistruar OJQ, lidhur me obligimet që kanë dhe dokumentet mund t'i nxjerrin.

Njoftohen të gjitha OJQ-të se për arsye të një lëshimi teknik, kjo thirrje është rishpallje e thirrjes të shpallur më datë 22/05/2024. Andaj, projekt-propozimet e dërguara deri më tani në email adresën projektet.mpjd@rks-gov.net duhet të ridërgohen edhe një herë.